



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KRYETARI**

Nr. 116 Prot.

Maliq, më 13/01/2022

Lënda: Njoftim

Drejtoria e teknologjisë së informacionit dhe marrëdhënieve me publikun

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, gërma (a), në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15 pika, neni 19; Udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, neni 11 dhe Urdhrit të Kryetarit Nr. 04 , Datë 12 .01.2022 po ju dërgojmë njoftimin për shpallje për “Përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Maliq”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu**



*Nr. 07 Prot
Dt. 17.01.2022*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. Prot 99

Maliq më, 12.01.2022

URDHËR

Nr. 4, datë 12 /01/2022

“Për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Maliq”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, gërma (a), në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 15 pika, neni 19; Udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, neni 11, Vendim të Këshillit të Qarkut Korçë nr. 21, dt 22.12.2022 “Për miratim linjash rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve”,

URDHËROJ:

- 1- Të hapet konkursi për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linja rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve si më poshtë :

Nr.	Linja	Oraret
1.	Podgorie-Pogradec-Podgorie	Nisja: Kthim:
		07:00 09:00
		07:30 09:30
		08:30 12:00
		09:00 12:30
		09:30 13:00
		10:00 13:30
		11:30 14:00
		12:00 14:30
		13:30 15:00
		14:00 15:30
		14:30 16:00
15:00 16:30		

- 2- Ngritjen e komisionit vlerësues të përbërë nga:

1. Johan	Thomo	-	Drejtorja Juridike
2. Erisa	Çekrezi	-	Spektori i të ardhurave dhe licencimit
3. Kastriot	Malushi	-	Drejtorja mekanike

- 3- Komisioni i ngritur në pikën 2 të këtij Urdhëri, për përzgjedhjen e operatorit do të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, dt. 18.11.2016, të ndryshuar, si më poshtë:

- a. Kërkesa.
- b. Formulari i autodeklarimit (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- c. Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- d. Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- e. Dokumentacioni i kredibilitetit bankar.
- f. Çertifikata e kompetencës profesionale në transportin rrugor (në rast se subjekti disponon më shumë se një mjet).
- g. Çertifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B. (me seli në teritorin e Bashkisë Maliq)
- h. Leja e qarkullimit (për çdo autobus).
- i. Çertifikata e kontrollit teknik (për çdo autobus).
- j. Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve (për çdo autobus).
- k. Çertifikata e kalibrimit të tahografit (për çdo autobus).
- l. Kontrata për sigurimin e automjetit (për çdo autobus).
- m. Kontrata për sigurimin e pasagjerëve (për çdo autobus).
- n. Leja e drejtimit.
- o. Çertifikata e Aftësisimit Profesional.
- p. Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij).
- q. Kontrata me agjensinë për transport udhëtarësh brenda vendit.
- r. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitetet në periudhën e mëparshme).

- Dokumentacioni dorëzohet në original ose fotokopje e noterizuar.

- 4- Komisioni të pranojë dokumentacionin e paraqitur pranë Bashkisë Maliq, deri në datën 28/11/2022.
- 5- Drejtoria e të Ardhurave të bëjë njoftimin për publikim për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Maliq ku të përcaktohen:
 - Linja rrethqytetëse për të cilën do të bëhet përzgjedhja e operatorit/operatorëve
 - Dokumentacionin që duhet të paraqesin operatorët pjesëmarrës
 - Afati brenda të cilit duhet të paraqiten dokumentat
- 6- Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Komisioni Vlerësues.
- 7- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë .

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPOIU

